



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.124/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rafet Haxhaj kryesues, Gyltene Sylejmani dhe Afijete Sada-Gllokhani anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Ardian Maxhuni, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Dragash, për shkak të vendosjes së posterave në objekte publike, për Zgjedhjet Lokale 2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 06.10.2017, mori këtë:

### V E N D I M

**Pranohet** si e bazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Prishtinë ZL.Anr.124/2017 të datës 04.10.2017, ndërsa subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Dragash, i shqiptohet dënimi më gjobë në vlerë prej 1.850,00 (njëmijë e tetëqind e pesëdhjetë) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

### A r s y e t i m

PZAP-i ka pranuar një ankesë me datë 04.10.2017 nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me të cilën pretendon se me datë 02.10.2017, në orën 16:40, në rrugët “Ymer Prizreni” dhe “Kodra e Llollajve”, nga qendra e qytetit, aktivistët nga radhët e subjektit politik (LVV), kanë vërejtur se në shtylla elektrike dhe në trafostacion është vendosur poster i kandidatit për Anëtar të Kuvendit Komunal në Dragash Ezxhan Emmini nga radhët e subjektit politik LDK.

Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e dispozitës së nenit 33 pika b) e LZP-së, neni 4 parag. 1 pika b) e Rregullës Zgjedhore nr.11/2013 e KQZ-së, neni 3.4 i Rregullës Zgjedhore nr. 13/ 2013 të KQZ-së. Me propozim për panelin që të merren masa ndëshkuese ndaj subjektit politik LDK.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur tri (3) fotografi, lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigjen në ankesë të datës 05.10.2017, subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), ka theksuar se LDK-ja ka informuar në mënyrë të duhur dhe me kohë anëtarët e subjektit dhe mbështetësit e tyre rreth dispozitave të Kodit të Mirësjelljes gjatë fushatës zgjedhore. Mirëpo, për shkak të numërit të madhë të kandidatëve nuk kemi pasur mundësi të parandalojm veprimet e ndaluara të kandidatëve. Përgjigjes në ankesë i janë bashkangjitur dy (2) fotografi , me të cilën vërtetohet se është evituar shkelja.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoj se:

### **Ankesa është e bazuar**

Paneli nga fotografitë e bashkangjitura si provë ankesës nga parashtruesi i ankesës, të cilat gjenden në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimtë ka konstatuar se posteri i kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Dragash Ezxhan Emmini, nga radhët e subjektit politik LDK, është vendosur në shtyllë elektrike dhe trafostacion, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 33, pika b), të LZP-së e cila përcakton: “*Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në objekte apo në hapsira publike*”.

Paneli me rastin e vendosjes së gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, me rastin e vendosjes lidhur me gjobën e shqiptuar mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret, ngase, subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara, që do të thotë se janë njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe për kundër këtij fakti posterat e kandidatit të këtij subjekti politik janë vendosur në objekte dhe në hapësirë publike. Po ashtu, si rrethanë Paneli e mori edhe faktin që subjektit politik në fjalë, ia dha mundësinë për tu përgjigjur, ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre, shihet qartë se brenda afatit të caktuar kanë ndërmarrë veprime për të bërë përmirësimin e shkeljes ashtu që i njëjti ka tërhequr posterat nga vendi i palejuar, i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
ZL.Anr.124/2017 më datën 06.10.2017

**Kryesuesi i Panelit**  
Rafet Haxhaj

### ***Këshilla Juridike:***

*Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par.4të LZP-së.*

